



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

ZYRA E REKTORIT - ARKIVËS

NR. 1081 PROT.

DATA 03.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

Nr. 9 Prot.

Vlorë më, 03.05.2024

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 03.05.2024**

**PËR NJË SAKTËSIM TË VENDIMIT NR.2 DATË 29.04.2024 "PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË NË FAKULTETIN DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË FAKULTETIN E SHËNDETIT"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bazuar në Nenin 19, pika 1, shkronja nj), të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në Vendimin Nr.19, datë 23.04.2024, pika 3 dhe 4, të Senatit Akademik "Për një saktësim në Nenin 3 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin 'Ismail Qemali', Vlorë", si dhe zbatim të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë", Neni 18 pika 3, Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shëndetit

**VENDOSI:**

1. Saktësimin i lëndës dhe Pikës 1, të Vendimit Nr.2 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shëndetit, datë 29.04.2024, në respektim të Nenit 19, pika 1, shkronja nj), të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Ndryshimet janë si më poshtë vijon;

**Ishte:**

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË NË FAKULTETIN DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË FAKULTETIN E SHËNDETIT**

1. Data 07.05.2024 shënon ditën e fillimit të procedurës për regjistrimin e kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë dhe Anëtarë të Komisioneve të Përhershme në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

**Bëhet:**

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE DHE DREJTUES TË NJËSISË BAZË NË FAKULTETIN NË FAKULTETIN E SHËNDETIT**

1. Data 07.05.2024 shënon ditën e fillimit të procedurës për regjistrimin e kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe Drejtues të Njesisë Bazë në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHËNDETIT

2. Saktësimin e lëndës së njoftimit shoqërues të Vendimit Nr.2, datë 29.04.2024, si më poshtë vijon;

**Ishte:**

PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

**Bëhet:**

PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE DHE DREJTUES TË NJËSISË BAZË NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

3. Heqjen e pikës 2 '*Kandidatët për Anëtarë të Komisioneve të Përhershme të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon*' dhe 3 '*Kandidatët për Anëtarë të Komisioneve të Përhershme të Njesisë Bazë nga radhët e studentëve duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon*' nga njoftimi, datë 29.04.2024.
4. Në pikën 1 të Njoftimit 'Për dokumentacionin e nevojshëm...', datë 29.04.2024, në pikën 1 '*Kandidatët për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe Drejtues të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon*', hiqjen e '-Deklarimi për neutralitetin politik, për mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend' në respektim të Vendimit nr.19, datë 23.04.2024 të Senatit Akademik të Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë.
5. Ndryshimin e shkronjës c), pika 1 në Njoftimin 'Për dokumentacionin e nevojshëm...', datë 29.04.2024, si më poshtë vijon;  
**Ishte:** 'Formularët e vetëdeklarimit'  
**Bëhet:** 'Formularin e vetëdeklarimit'
6. Vendimi i saktësuar të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shëndetit**

Vasilika Prifti (Kryetare)  
Stiliana Brokaj (Anëtare)  
Ela Kamberaj (Anëtare)

Sekretare e KZF  
Erlini Kokalla